



KRYEGJYSHATA BOTËRORE BEKTASHIANE
SELIA E SHENJTË

Nr. 185 Prot.

Tiranë, më 15 / 03 / 2023



AKADEMIA E STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE

Nr. 119 Prot.

Tiranë, më 15 / 03 / 2023

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM

MES

AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TIRANË
DHE
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Memorandumi për bashkëpunim nënshkruhet mes Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, përfaqësuar nga rektori i Akademisë, prof. dr. Luan Përzhita nga njëra anë dhe Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj nga ana tjetër.

Neni 1

Qëllimi i memorandumit është të zgjerohet bashkëpunimi i ndërsjellë i palëve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje në fushën e aktivitetit shkencor, gjurmues dhe arsimor.

Neni 2

Aktivitetet e përbashkëta të palëve nënshkruese të marrëveshjes do të organizohen në kuadër të fushave themelore të bashkëpunimit, të përmendura në nenin 4 të këtij Memorandumi.

Në bazë të përvojave që do dalin gjatë realizimit të kësaj marrëveshjeje, fushat mund të zgjerohen me anekse plotësuese.

Neni 3

Duke bashkëpunuar përmes këtij Memorandumi, palët nënshkruese detyrohen që t'u përmbahen normave juridike zyrtare që rregullojnë aktivitetet: arsimore, shkencore, kulturore, marrëdhëniet e jashtme ekonomike.

Neni 4

Palët nënshkruese janë dakord që në varësi nga mjetet financiare që disponojnë dhe marrëveshjes së ndërsjellë, bashkëpunimin ta realizojnë përmes formave që vijojnë:

- a) Përgatitje të projekteve me interes të përbashkët;
- b) Organizim i përbashkët i konferencave shkencore, seminareve;
- c) Publikim të punimeve, të cilat janë me interes të përbashkët për palët nënshkruese të Marrëveshjes;
- d) Lehtësi veprimi në bibliotekat dhe arkivat për anëtarët e të dyja institucioneve;
- e) Shkëmbim i publikimeve dhe librave, botime të palëve nënshkruese;
- f) Shkëmbim materialesh arkivore respektive.

Neni 5

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.
Memorandumi nënshkruhet me afat kohor 4 (katër) vjeçar.
Nëse nuk kundërshtohet, vijon të jetë efektive edhe më tej.

Neni 6

Secili nen i këtij Memorandumi mund të ndryshojë ose të plotësohet pas arritjes së pajtimit nga të dyja palët.

Memorandumi mund të prishet me kërkesën e cilësdo nga palët nënshkruese. Në rast të tillë, pala nënshkruese duhet ta informojë palën tjetër nënshkruese në formë të shkruar, jo më vonë se 6 muaj para prishjes së Memorandumit.

Mosmarrëveshjet zgjidhen përmes negociatave.

Neni 7

Memorandumi është përgatitur në 2 kopje.

KRYEGJYSHATA BOTËRORE BEKTASHIANE

SELIA E SHENJTË

**KRYEGJYSHI BOTËROR BEKTASHIAN
SHKËLQESIA E TIJ**

Haxhi Dede Edmond Brahimaj

Haxhi Dede Edmond Brahimaj



AKADEMIA E STUDIMEVE

ALBANOLOGJIKE

REKTOR

Prof. dr. Luan Përzhita

